

Financim nga BE-ja për trajnim deri në 3 muaj pranë një biznesi të huaj

Erasmus for Young Entrepreneurs - Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj

Qendra për Promovimin e Konkurrueshërisë është përzgjedhur si Organizata Ndërmjetëse për Shqipërinë për Programin ERASMUS FOR YOUNG ENTREPRENEURS, në Konsorcium me 6 organizata në Poloni, Hungari, Bullgari, Itali, Spanjë dhe Portugali, me projektin “Entrepreneurship is Woman”. Koncepti i projektit është inkurajimi, zhvillimi dhe mbështetja e iniciativave sipërmarrëse duke krijuar lidhje dhe shkëmbime ndërmjet formave të ndryshme të ekonomisë dhe novacionit, dhe duke ofruar veçanërisht perspektiva të reja për gratë sipërmarrëse.

Çfarë është Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj?

Erasmus for Young Entrepreneurs është një skemë mobiliteti ndër -Evropiane për sipërmarrësit, e iniciuar nga Bashkimi Evropian në vitin 2009. Programi synon t'i ofrojë mundësi sipërmarrësve të aspiruar apo sapo themeluar për të shkuar jashtë vendit diku brenda Evropës, për të zhvilluar kompetencat e tyre sipërmarrëse në drejtimin e një biznesi të vogël duke punuar pranë një sipërmarrësi pritës.

Programi synon të forcojë aftësitë sipërmarrëse duke i pajisur **sipërmarrësit e rinj** me aftësi dhe kompetenca të nevojshme për të ardhmen e tyre ose për bizneset e krijuara rishtas.

Programi ndihmon gjithashtu edhe **sipërmarrësit pritës** të arrijnë në tregje të reja dhe të zhvillojnë bizneset e tyre duke përfituar nga idetë inovative ose teknika të sipërmarrësve të rinj disa prej të cilave mund të materializohen në produkte ose shërbime.

Kush përfiton?

Sipërmarrësit e rinj që konsiderohen:

1. Persona që planifikojnë të fillojnë biznesin e tyre bazuar në një projekt konkret, i cili pasqyrohet në një plan biznesi të shkruar, pa kufizime për moshën apo sektorin.
2. Sipërmarrësit që janë në fazën e hershme të zhvillimit të tyre, në më pak se 3 vite eksperiencë në drejtimin e biznesit.

Sipërmarrësit Pritës që konsiderohen:

1. Sipërmarrës të suksesshëm dhe me eksperiencë minimumi deri në 3 vite në drejtimin e një ndërmarrjeje mikro, të vogël apo mesatare (SME);
2. Pronarët e një SME ose persona direkt të angazhuar në sipërmarrje në nivel të bordit menaxhues të SME-së.

Cilat janë përfitimet?

Sipërmarrësi i Ri

- Përfiton nga një trajnim në punë në një kompani pritëse jashtë vendit për të zhvilluar aftësitë sipërmarrëse

- Fiton njohuri biznesi dhe eksperiencë në menaxhimin e një biznesi të vogël. Përfiton nga një trajnim në punë në një kompani pritëse jashtë vendit për të zhvilluar aftësitë sipërmarrëse.
- Sipërmarrësi i Ri shpenzon kohë jashtë vendit brenda një shteti të BE-së ose vend pjesëmarrës në Programin COSME, ku ata do të bashkëpunojnë/punojnë me Sipërmarrësin pritës për një periudhë qëndrimi nga 1 deri në 6 muaj.

Procesi i aplikimit është i ndarë në katër faza dhe mundësohet nga Organizata Ndërmjetëse:

- Faza e Aplikimit: Nëse kandidati është i ligjshëm aplikon në faqen online të programit www.erasmus-entrepreneurs.eu;
- Faza e bashkimit: kur sipërmarrësit fillojnë bashkëpunimin dhe diskutojnë për Planin e Veprimtarive që duhet të përmbushet gjatë qëndrimit aty;
- Faza përgatitore dhe Kontraktuale;
- Faza e Implementimit

Kush e financon Programin?

Mbështetja financiare ofrohet për sipërmarrësit e rinj nga programi i Komisionit Evropian që kontribuon për udhëtimin dhe qëndrimin në një vend të BE-së, me një kuotë fikse mujore e përcaktuar në varësi të shtetit ku do të qëndrojnë sipërmarrësi i ri.